



01.02.2019

C.nr.512/18

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Misin Frangu dhe praktikanten Filloreta Hasani, në çështjen juridike, të paditësit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Komuna Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqson [REDACTED] avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna e Ferizaj -Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson me autorizim [REDACTED] jurist i diplomuar nga Ferizaj, në çështjen për pagesë e pagave përcjellëse dhe jubilarë, në prezencën e paditësit dhe të autorizuarit të tij, si dhe të përfaqësuesit të të paditurës, në shqyrtimin e mbajtur me datë 29.01.2019, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET, pjesërisht si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Komuna Ferizaj.

II.DETYROHET, e paditura Komuna e Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, që paditësit në emër të tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit në lartësi prej 1.411.38 €, dhe tri pagave jubilarë në lartësi prej 1.411.38 €, e që shuma e përgjithshme prej **2,822.72 € (dymijë e tetëdhjet e njëzet dy euro shtatëdhjet dy cent)**, të cilën shumë e paditura është obliguar t'ia paguaj paditësit, së bashku me kamatën, e cila do të llogaritet sipas lartësisë që llogarisin bankat për deponimet e rëndomta të qytetareve, të afatizuara për periudhë një vjeçare, pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e deri në pagesën definitive.

III.OBLIGOHET, paditësi të u a paguaj shpenzimet e kësaj procedurë në shumë prej **269.00 €**, për të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësi [REDACTED] përmes përfaqësuesit të tij avokat [REDACTED] me datë 29.01.2019, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Ferizaj-Drejtoria e Arsimit, lidhur me pagesën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe pagesën e tri pagave jubilarë.

Pretendimet e palëve:

Përfaqësuesi i paditësit në seancat e mbajtira dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi si në padi dhe kërkespadi dhe ka bërë precizimin e kërkesëpadi së duke kërkuar që paditësit ti paguhet tri paga përcjellëse në shumën prej nga 1, 411.38 euro, dhe tri paga jubilarë në shumën prej 1, 411.38 euro, shuma e përgjithshme prej 2,822.76 euro, i ka propozuar gjykatës që padien dhe kërkespadien paditësit ta aprovoj në tërësi si të bazuar me ligj, i ka kërkuar shpenzimet e procedurës dhe ato në 104 euro për përpilimin e padisë, 135, për seancën e datë 29.01.2019, si dhe 30 euro për taksën gjyqësore për padi.

Përfaqësuesi i të paditues ka deklaruar në tërësi si në përgjigjëje në padi duke e kundërshtuar kërkespadi e paditësi si të pa bazuar, në bazë të dispozitave të nenit 36 pika 9 dhe 10 e kontratës kolekrive nr.21. e datë 11.04.2017, e lidhur në ndërmjet SBASHK-ut, në një anë dhe MASHT-it, në anën tjetër është precizuar sakëtesisht rregulla e përgjithshme me pagat, ku në pikën 9 të kësaj dispozite përfituesit e pagave jubilarë me rastin e pensionimit përfitojnë të drejtën e pagës bazë, paga bazë për mësimdhënësit e arsimit fillor është 405 euro. Duke u bazuar në listën e pagave që janë në shkresat e lëndës konstatohet se paditësi për muajin nëntor 2016 ka realizuar pagën prej 470.46 euro për muajin dhjetor 2016 ka realizuar pagën prej 470.46 euro. I ka propozuar gjykatës që kërkespadien e paditësit ta refuzoj si të pa bazuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtës të gjendjes faktike të çështjes, për atë sa palët ndërgjyqëse i parashtruan ato në këtë procedurë, bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, ka bërë administrimin e provave si vijojnë ka lexuar vërtetimi me nr. protokollin 209 i datës 19.01.2017, Kontrata e punës me nr protokollin 214 e datës 01.03.2015, formulari për kërkesë apo ankesë e datës 28.02.2017, Libreza e punës me nr të regjistrin 6333/74 në emër të paditësit [REDAKTUAR], vërtetimi me nr 210 i datës 19.01.2017, regjistri i pagave në emër të [REDAKTUAR] diploma në emër të [REDAKTUAR], përgjigjia në padi e datës 10.01.2019, listat e pagave të dorëzuara nga përfaqësuesi i Komunës [REDAKTUAR]

Gjykata duke i vlerësuar provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike, se nuk është kontestuese në mesë palëve se paditësi për shkak të arritjes së moshës 65 vjeçare ka shkuar në pension, e paditura nuk e ka kontestuar pretendimet në padi nga ana e paditësit se ka përvojën e punës mbi 40 vjet.

Me leximin e Kontrata e punës me nr. Protokolli 214 e dt.01.03.2015, Gjykata ka konstatuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura deri në momentin e pensionimit me datë 01.01.2017.

Me leximin e listës së pagave për tri pagat e fundit, gjykata ka konstatuar se paditësit tri pagat në tre mujorin e fundit i ka realizuar për 470.46 €.

Gjykata me rastin e përcaktimit të lartësisë për tri pagat jubilarë në shumën prej 1,411.38 €, si dhe tri pagave jubilarë në lartësi prej 1.411.38 €, e që shuma e përgjithshme i bie **2,822.72** € (dymijë e tetëdhjet e njëzet dy euro shtatëdhjet dy cent) e ka marrë për bazë kontratën e punës të lidhur në mes paditësit dhe të paditurës, si dhe listën e tri pagave të fundit që gjenden në shkresat e lendes, me ane e të cilave vërtetohet se paditësi në muajt fundit para daljes në pension dhe atë në nëntor, dhjetor dhe janar, ka pasur pagën mujore për shumën prej 470.46 €.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadiës është bazuar në faktin se me kontratën kolektive të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 53 të kësaj kontrate përcaktohet se kjo kontratë hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët ndërsa zbatohet prej 01 Janar të viti 2015 , ndërsa me nenin 51 të kësaj kontrate zbatohet në rastin ku ka implikime financiare.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditësi e ka shfrytëzuar një të drejtë pasi që i njëjti përfiton nga kjo kontrate për faktin se me rastin e daljes se tij në pension kontrata kolektive ka qenë në fuqi e cila nuk është kontestuar nga ana e të paditurës.

Në nenin 36 par. 9 pika 9.1 dhe 9.23, të kontratës kolektive për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm është përcaktuar që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vite të përvojës në punë të punëdhënësi, i fundit në vlerë të një page bazë, për 20 vite të përvojës në punë të punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy pagave bazë dhe për 30 vite të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë prej tri pagave bazë, punëdhënësi i fundit është ai që e paguan shpërblimin jubilar, të shpërblimi jubilar paguhet në afat prej 1 muaji pas plotësimit të kushteve nga kjo pikë, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e daljes në pension paditësit brenda 1 muaji sipas nenit 36 par. 9 pika 9.5 të ia paguajë tri paga jubilarë pasi që i ka plotësuar këto kushte, pasi ka pasur përvojën e punës mbi 40 vjeçare dhe ka qenë obligim i të paditurës që të bëjë pagesën pa pasur nevojë as për të paraqitur ndonjë kërkesë çoftë gojore apo me shkrim të paditurës.

Kurse neni 36 par. 10 të Kontratës kolektive për të punësuarit në arsim fillor dhe të mesëm në Kosovë, është përcaktuar se punëtori ka të drejtë që me rastin e pensionimit në pagesat përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, e në rastin konkret Gjykata ka marr parasysh që tri pagat e fundit të punëmarrësit kanë qenë 470.46 € dhe nuk ka pas ndonjë ndryshim në tre muajt e fundit para daljes në pension dhe me rastin e vendosjes është bazuar në këtë fakt se meqenëse nuk ka pasur ndryshime në pagat që të merret një mesatare e ka marr për bazë tri pagat e fundit që ka ndodh në rastin konkret rezulton se paditësi ka pasur pagën mujore tek e paditura shumë prej 470.46 €.

Pretendimet e përfaqësuesit të paditurës se paditësi kërkesën për kompensimin e pagave përcjellëse duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka pasur fonde të veçanta që ti përmbushë këto detyrime, këto pretendime për Gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 2 të kësaj kontrate të gjitha DKA, në rastin konkret e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive dhe me kohë të planifikojë buxhetin për këto raste, e jo të thirret se nuk ka mjete të destinuar për këto raste, andaj edhe përgjegjësia në rastin konkret është tek e paditura e jo tek paditësi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, Gjykata në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, ka obliguar të paditurën që t'ia kompensoj shumën prej 269.00 €, €, për përpilim të padisë shumën prej 104.00 €, për seancë të mbajtur shumën prej:135.00 €. dhe taksën gjyqësore për padi në shumë prej 30.00 €.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.512/18 më datë 29.01.2019



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të kopjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVO

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më
Dana 11. 02 2019

Republika e Kosovës  Republika Kosovo

VENDIMI ËSHTË I EKZEKUTUESHËM
ODLUKA JE IZVRŠNA

Më dt. 19. 02. 2019 vit.
Dana 19. 02. 2019 god.

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik

